



**REPUBLIKA E SHQIPERISË**  
**MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT**  
**AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT**  
**DREJTORIA E VLERËSIMIT TË IMPAKTIT DHE LIÇENSIMIT**

AN240420240002

Tiranë, më: 04.06.2024

Komisioni 68

**DEKLARATË MJEDISORE**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 12/2015 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, VKM Nr. 686, datë 29.7.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësisë e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore” dhe me propozim të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Ministri

**VENDOSI:**

Lëshimin e Deklaratës Mjedisore për **Zhvilluesin** me të dhënat si më poshtë:

**Person Juridik:** “KELVIS 2013” sh.p.k  
**Nr. NIPT-i** L33929201F  
**Adresa e selisë:** Durrës Nikël Rruga Internacionale Tiranë-Krujë, Km-9, Qerekë  
**Person Juridik:** Ramazan Sinanaj

Për të zhvilluar projektin: **“Instalime për asgjësimin e mbetjeve për incinerimin, trajtimin kimik, sipas seksionit D9, ose venddepozitimet e mbetjeve të rrezikshme, siç përcaktohet në ligjin “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”.”**

Aplikimi është bërë referuar Ligjit Nr. 10440, datë 7.7.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, të ndryshuar, Shtojca I: Pika 9. Instalime për asgjësimin e mbetjeve për incinerimin, trajtimin kimik, sipas seksionit D9, ose venddepozitimet e mbetjeve të rrezikshme, siç përcaktohet në ligjin “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”.

**Vendndodhja:** Rruga Internacionale Tiranë – Krujë, km 9, Qerekë, Nikël, Durrës

**Të dhëna teknike:**

Marka: FORTEC – EXCE AN 25  
Sipërfaqja e instalimit: 42 m<sup>2</sup>  
Vëllimi i dhomës së diegies: 2.5 m<sup>3</sup>  
Materiali: Celik i karbonizuar

1 Portë-Për futjen e mbetjeve te kafshëve

1 Portë-Për nxjerrjen e hirit

Temperatura: 860 - 1000°C

Lartësia e oxhakut: 8 m

Kapaciteti maksimal: 750 kg

Kapaciteti për orë: 200 kg

*(Bashkangjitur vendimit, gjeni aneksin me hartën topografike dhe koordinatat metrike, ku tregohet vendodhja e objektit)*

Bazuar në nenin 12, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, i ndryshuar, i sugjerohet autoritetit planifikues:

**Miratimi i lejes/licencës së zhvillimit të atij projekti, me kushtet që duhet të përmbushen nga zhvilluesi, për të parandaluar, minimizuar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis;**

Bazuar në pikën 2, të nenit 12, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, të ndryshuar, më poshtë po listojmë:

### **1. Qëndrimin e Ministrisë dhe sipas rastit, kushtet që duhet të përmbushen nga zhvilluesi:**

*Drejtoritë Teknike të Ministrisë shprehen:* Referuar kërkesës së subjektit “Kelvis 2013” sh.p.k. me nr AN240420240002 aplikimi, datë 24/04/2024 në lidhje me kërkesën për Deklaratë Mjedisore për procedurën e thelluar të VNM-së për projektin “Instalim inceneratori”, me vendndodhje në Durrës, bazuar në pikën 11, të Kreut II, të VKM nr. 686, datë 29.07.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësi e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit dhe deklaratës mjedisore”, të ndryshuar, drejtoritë teknike të ministrisë shprehin mendimin si më poshtë vijon:

• Drejtoria e Ndryshimeve Klimatike shprehet me rekomandimet si më poshtë vijon:

Në zbatim të legjislacionit përkatës për fushën e cilësisë së ajrit në mjedis, sugjerohet që gjatë fazës së ndërtimit dhe funksionimit të inceneratorit, të mbahen në konsideratë rekomandimet e mëposhtme: - Të respektohen normat e lejuara të shkarkimeve në ajër të ndotësve të gaztë dhe lëndës së ngurtë pezull, në zbatim të VKM-së nr. 435, datë 12.9.2002 “Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë”; - Të bëhet monitorim periodik i kushteve teknike të inceneratorit dhe autoklavës dhe mbajtje nën kontroll të parametrave të tyre, për të parandaluar dhe shmangur, emetimin e ndotësve të gaztë. - Lënda djegëse që do të përdoret të jetë në përputhje me VKM-në nr. 429, datë 26.6.2019 “Për cilësinë e disa lëndëve të djegshme, të lëngëta, për përdorim termik, civil e industrial, si dhe përdorim në mjetet e transportit ujor (detar, lumor dhe liqenor)”, si dhe VKM-në nr.147, datë 21.3.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse, benzinë dhe diesel”. Në zbatim të legjislacionit përkatës për fushën e menaxhimit të kimikateve, sugjerohet që gjatë fazës së ndërtimit, të mbahen në konsideratë rekomandimet e mëposhtme: - Subjekti dhe punonjësit duhet të jenë të familjarizuar dhe të respektojnë në mënyrë rigorozë masat dhe rekomandimet për mbrojtjen, sigurinë e njeriut dhe mjedisit, nga kimikatet që do të përdoren për qëllime të këtij aktiviteti, në zbatim të ligjit nr. 27/2016 “Për menaxhimin e kimikateve”; - Kimikatet ose produktet/artikujt që i përmbajnë ato, që do të përdoren, të jenë të klasifikuara, etiketuara, paketuara dhe të shoqërohen me dokumentacionin me të dhënat e sigurisë kimike (MSDS), sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi (VKM-së nr. 488, datë 29.6.2016 “Për klasifikimin, etiketimin dhe ambalazhimin e kimikateve”, si dhe VKM-së nr. 9, datë 9.1.2019 “Për rregullat e detajuara dhe metodat për kryerjen e vlerësimit të sigurisë së kimikatit, si edhe kërkesat specifike, përmbajtja dhe formati i dokumentit me të dhënat e sigurisë”) - Kimikatet ose

produktet/artikujt që i përmbajnë ato, që do të përdoren, të ruhen dhe menaxhohen në mënyrë të sigurt, në zbatim të ligjit nr. 27/2016 “Për menaxhimin e kimikateve”. • Në zbatim të legjislacionit përkatës për fushën e ndryshimeve klimatike, rekomandohet të kryhen punime miqësore me mjedisin dhe të përdoren materiale të rinovueshme dhe lokale. Lidhur me bazën ligjore të cituar në raportin e VNM-së, shprehemi si më poshtë vijon: • Ligji i cituar në raport nr.10266/2010 “Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja” është shfuqizuar dhe aktualisht është në fuqi ligji nr. 162/2014 “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis”, i cili shoqërohet me disa akte nënligjore të dala në zbatim të tij. • Vihet re se në këtë raport nuk është cituar ligji aktual në fuqi nr. 27/2016 “Për menaxhimin e kimikateve”. • Vihet re se në këtë raport nuk është cituar as ligji në fuqi nr. 155/2020 “Për ndryshimet klimatike”.

• Drejtoria e Ekonomisë Qarkulluese sugjeron që zhvilluesi duhet të përmbushë detyrimet për menaxhimin e mbetjeve, në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi, në fushën e mbetjeve, si më poshtë vijon:

• Gjatë zhvillimit të aktivitetit mbetjet inerte të gjeneruara të trajtohen sipas kërkesave të

VKM nr. 575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”.

• Të zbatohet Ligji nr. 10 463, date 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar.

• Të respektohen kërkesat e VKM nr. 418, date 25.06.2014 “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim”.

• Mbetjet që do të krijohen, të specifikohen sipas kodeve të VKM nr. 402, datë 30.06.2021 “Për miratimin e katalogut të mbetjeve”.

• Transferimi i mbetjeve jo të rrezikshme të shoqërohet me plotësimin e shtojcës 1 të VKMnr. 229, datë 23.04.2014 “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme”, të ndryshuar.

• Mbetjet e rrezikshme, të dorëzohen sipas VKM nr. 371, datë 11.06.2014 “Për përcaktimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe miratimin e dokumentit të dorëzimit të mbetjeve të rrezikshme”, të ndryshuar.

• Subjekti që do të transportojë ose do të transferojë mbetjet të jetë i pajisur me licensë III.2.B, si detyrim i nenit 57, të ligjit nr. 10463, date 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”.

• Për të gjitha mbetjet nga ambalazhet të zbatohet VKM nr. 177, datë 06.03.2012, “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre”, i ndryshuar.

Në veprimtarinë për të cilën aplikon subjekti, menaxhimi i mbetjeve të bëhet sipas parimit të përgjegjshmërisë ndaj mjedisit, në përputhje me VKM nr. 418, datë 27.5.2020 “Për miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike dhe të Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve 2020-2035”, duke synuar uljen e sasisë së mbetjeve të gjeneruara dhe menaxhimin e integruar të mbetjeve.

• Drejtoria e Natyrës dhe e Pyjeve sugjeron si më poshtë vijon:

Të dy sektorët si pyjet ashtu dhe sektori i mbrojtjes së natyrës për këtë aktivitet shprehen se është jashtë fushës së përgjegjësisë të sektorit.

Bazuar në nenin 12, pika 1 e ligjit nr . 10440 / 2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" të ndryshuar, në rast se zgjidhni pikën “a” apo “b” të referencës ligjore së sipërcituar, në Deklaratën Mjedisore të vendosen kushte të detajuara përsa i përket mbrojtjes së biodiversitetit, menaxhimit të pyjeve, emetimeve në ajër, shkarkimeve të ujrave të ndotura, menaxhimit të mbetjeve, etj. të cilat duhet të përmbushen nga zhvilluesi, për të parandaluar, minimizuar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis.

*Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura shprehet :* Bazuar në dokumentacionin dhe koordinatat e aplikimit, sipërfaqja ku do të zhvillohet aktiviteti: “Instalime për asgjësimin e mbetjeve për incinerimin, trajtimin kimik, sipas seksionit D9, ose venddepozitimet e mbetjeve të rrezikshme, siç përcaktohet në ligjin “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, Durrës Nikël Qerekë, Rruga

Internacionale Tiranë-Krujë, Km-9, Qerekë, Zona Kadastrale 3096, Pasuria 106/7, me zhvillues “KELVIS 2013” dhe aplikues “Dritan Arapi”, me nr. Aplikimi AN240420240002, nuk ndodhet brenda rrjetit të zonave të mbrojtura.

*Agjencia Rajonale e Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër shprehet:* Pas shqyrtimit të dosjes së VNM së Thelluar të paraqitur nga zhvilluesi “Kelvis 2013” sh.p.k për veprimtarinë “Instalim inceneratori” me vendndodhje në rrugën Internacionale Tirane – Krujë, km 9, Qereke, Nikël, Durrës, Agjencia Rajonale e Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër sugjeron që subjekti të marrë masat që zhvillimi i projektit të kryhet në harmoni me mjedisin dhe me ndikim sa më minimal në të. Sugjerojmë zbatimin e masave të listuara më poshtë:

- Të zbatohet Ligji nr. 10 463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar.
- Teknologjia e përdorur të jetë sipas standardeve ndërkombëtare për të menaxhuar shkarkimin e ujërave, kimikateve dhe gazeve që do të akumulohen nga procesi i grumbullimit dhe trajtimit të mbetjeve.
- Kompania gjatë fazës së operimit të trajtojë ujërat e ndotura (perkolato/ shllam/ leksivate), në Impiantin e Trajtimit të Ujërave të Ndotura.
- Gjate perimetrit të sipërfaqes ku do të operojë kompania të hapen kanale kulluese në mënyrë që të sistemohen ujrat sipërfaqësore të sheshit dhe të kontrollohet çdo lloj derdhje brenda sipërfaqes së projektit.
- Të mos shkarkohet asnjë lloj derdhje të mbetjeve inerte jashtë territorit të sheshit të projektit.
- Mbetjet urbane, të grumbullohen të ndare sipas llojit, si organike, të riciklueshme, dhe sipas rrymave të tjera prioritare në përputhje me përcaktimet dhe kërkesat ligjore për menaxhimin e mbetjeve dhe planet rajonale dhe lokale në fuqi.
- Të vendosen filtra me permasa nanometrike, me perberje karboni për të parandaluar emetimin e gazrave, që mund të çlirohen gjatë ushtrimit të aktivitetit.
- Të kryhet instalimi i membranave me përmbajtjen e enzimave specifike për të larguar aromat e pakëndshme që gjenerohen nga landfillimi i mbetjeve.
- Ambientet të rrethohen me një brez pemesh të larta, të cilat luajnë një rol shumë të rëndësishëm për minimizimin e zhurmave dhe permiresimin e cilesisë së ajrit

## **2. Informacion për procesin e realizuar të konsultimit me publikun:**

*Konsultimi me publikun:* Dëgjesa me Publikun u krye në datë 19.04.2024. Morën pjesë përfaqësues nga komuniteti i zonës, kryeplaku i fshatit, përfaqësues nga Bashkia Krujë, dhe nga Agjencia Rajonale e Mjedisit, dhe përfaqësues nga studio mjedisore. Nuk pati ndonjë shqetësim nga komuniteti për zhvillimin e këtij aktiviteti. Në takim është prezantuar aktiviteti, janë dëgjuar sugjerimet e pjesëmarrësve, të cilat do të merren parasysh nga ana e investitorëve, gjatë kohës së kryerjes së proceseve të punës. Nga ana e investitorëve iu sigurova të pranishmeve që do të merren të gjitha masat për eliminimin e ndikimeve negative në mjedis, duke mos cënuar jetën e banorëve.

## **3. Arsyet dhe konsideratat kryesore, ku është mbështetur mendimi;**

Zhvillimi i aktivitetit është në përputhje me:

- **Mendimin e Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura.**
- **Subjekti Juridik Kelvis 2013 sh.p.k, është pajisur me Vendim për VNM Paraprake në datën 14.08.2017, Komisioni 33, me vendndodhje: Qerekë, Nikël, Bashkia Krujë, Qarku Durrës.**

- Subjekti është i pajisur me Leje Mjedisore Tipi B në Komisionin nr.4, datë 04.02.2022, me PN-0928-02-2022, me vendndodhje: Qerekë, Nikël, Bashkia Krutjë, Qarku Durrës. Inceneratori i mbetjeve nga thertorja do të ndërtohet në funksion të aktivitetit.
- Në mendimin e anëtarëve të Komisionit 68, datë 04.06.2024, i mbledhur në zbatim të Urdhërin nr.82, datë 02.05.2024, për “Krijimin e komisionit teknik për shqyrtimin e kërkesave që i nënshtrohen procedurës paraprake dhe të thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis”.

**4. Përshkrimin, sipas rastit, të masave kryesore që duhen marrë për të shmangur, reduktuar e nëse është e mundur, për të korrigjuar efektet negative të rëndësishme:**

- 4.1 Ky objekt të ndërtohet në përputhje të plotë me Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Planin e Detajuar Vendor, të miratuar nga organet kompetente (KKT/Bashkia/Njësi Administrative) dhe akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
- 4.2 Aktiviteti të zhvillohet vetëm brenda sipërfaqjes dhe koordinatave të kërkuara në aplikim.
- 4.3 Në rast se gjatë punimeve shfaqen elemente të tillë si: objekte kulti, gjurmë arkeologjike, burime ujore etj, subjekti të ndërpresë punimet dhe të lajmërojë urgjentisht organet kompetente.

**Të instalohet inceneratori me standarte europiane, sa më miqësor me mjedisin. Ky instalim është i vlefshëm vetëm për incenerimin e kafsheve (Operimi i inceneratorit për asgjësimin e mbetjeve shtazore)**

**Gjatë fazës së instalimit:**

- 4.4 Të kryhen punime vetëm në gjurmët e projektit të propozuar.
- 4.5 Në asnjë mënyrë mos të ketë prerje pemësh.
- 4.6 Të merren masa për të parandaluar rëniet e zjarrit gjatë realizimit të punimeve në terren dhe të sigurohen mjetet e nevojshme të ndërhyrjes në rast të rënies së zjarrit (zjarrfikse të lëvizshme, bombula me shkumë, etj);
- 4.7 Niveli i zhurmave gjatë procesit të jetë brenda normave të lejuara 60DB – 70DB dhe të punohet në orare kur shqetësimi i banoreve dhe zonave përreth të jetë me ndikim sa më të ulët
- 4.8 Të bëhet rrethimi i zonës ku do të realizohen punimet, për të shmangur hyrjet e pautorizuara.
- 4.9 Operacionet për zbatimin e projektit (ndërtimi) të përdorin sa më shumë të jetë e mundur infrastrukturën egzistuese të transportit (rrugën dhe rrjetet egzistuese),
- 4.10 Kapanoni i shkarkimit të mbetjeve dhe seleksionimit fillestar të jete i shtruar me shtresa izoluese dhe fibra të posatshme që nuk lejojnë depertimin në shtresat e tokës;
- 4.11 Ujerat e ndotura të gjitha kategorive të kapen e trajtohen në një impant të posatshem që do të jete pjesë e projektit;
- 4.12 Kapanoni dhe zona operacionale të kene sistem të mbledhjes së ujerave sipërfaqesore dhe orinetimin e tyre në impjanit të trajtimit të ujerave të ndotura;
- 4.13 Gjatë fazës së instalimit të mbahet nën kontroll ndotja e ajrit, brenda standarteve të OBSH-së, e konkretisht: 90 mikrogram/m<sup>3</sup> për pluhurin total (LGS) dhe 50 mikrogram/m<sup>3</sup> për pluhurin e frymëmarrjes (PM 10).
- 4.14 Mjediset ku punohet të mbahen pastër, duke bërë edhe spërkatje me uje.
- 4.15 Subjekti të kujdeset për menaxhimi të mbetjeve inerte të krijuara gjatë fazës së ndërtimit sipas detyrimeve që janë të përcaktuara në VKM nr.575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”,
- 4.16 Të sistemohen mjediset përreth ndërtimit me gjelbërim.
- 4.17 Furnizimi me ujë të pishëm të bëhet në tubacionin kryesor, me miratimin të Shoqërisë Anonime “Ujësjellës-Kanalizime”.



- 4.18** Furnizimin me energji elektrike të bëhet konform kërkesave e me miratimin të organeve kopetente.
- 4.19** Subjekti të realizojë në mënyrë të menjëhershme cdo ndërhyrje teknike për të riparuar çdo fenomen negativ në mjedis si pasojë e veprimtarisë së tij.
- 4.20** Subjekti të ndjek me përpikmëri projektin teknik për të evituar erozionin e tokës, me qëllim ruajtjen e cilësisë së ujrave sipërfaqësore dhe nëntokësore.
- 4.21** Të vendoset sinjalistika paralajmëruese përgjatë gjithë segmentit të punimeve me qëllim shmangien e aksidenteve njerëzore.
- 4.22** Ne asnjë mënyrë mos të ketë shkarkime të dherave dhe ujerave të gjeneruara nga germimet në lumin Shkumbin.
- 4.23** Ne raste aksidentesh ose defektesh teknologjike që shkaktojnë ndotje të mjedisit, subjekti menjëherë duhet të jap informacion në DRM-në e qarkut përkatës dhe AKM, të cilat bëjnë të mundur njoftimin e popullatës që preket nga ky aksident.

**Në objektin e trajtimit duhet të përmbushen kërkesat e mëposhtme:**

- 4.24** Të zbatohet me rigorozitet rregullorja e vendit të punës.
- 4.25** Të lejohet hyrja vetëm e personave që kanë kualifikim për të administruar mbetjet.
- 4.26** Të tregohet kujdes për sigurinë e kontenierëve, të parandalohen rrjedhjet, të sigurohet mbrojtja nga uji, shiu dhe era.
- 4.27** Të jenë ndërtuar me material të qëndrueshme që pastrohen lehtësisht, që nuk lejojnë depërtimin e lëngjeve dhe të jenë rezistente ndaj parazitëve.
- 4.28** Gjatë zhvillimit të aktivitetit të trajtimit të mbetjeve të merren masa mbrojtëse kundër aromave të pakëndshme duke instaluar sistemin e ventilimi-filtrimit për eliminimin e tyre.
- 4.29** Te instalohet oxhaku, lartësia e te cilit të kalojë patjetër lartësine e objekteve me të afërta me te.
- 4.30** Te vendosen filtrat në oxhak, të cilët të nderrohen periodikisht në varesi të kapacitetit të trajtimit të mbetjeve.
- 4.31** Të merren masa për sigurimin teknik në ambientet e kompanisë, të bëhet sistemimi ajrosja e ventilimi i ambientit.
- 4.32** Trajtimi i mbetjeve në impiant të bëhet në një kohë sa më të shkurtër të mundshme duke ulur kohën e ekspozimit të tyre ndaj agjentëve të mjedisit;
- 4.33** Subjekti të mbajë rregjistër për sasinë e mbetjeve të trajtuara dhe të raportojë të dhënat cdo 6 muaj pranë Drejtorisë Rajonale të Mjedisit të qarkut përkatës.
- 4.34** Shkarkimet në mjedis të jenë nën vlerat e lejuara sipas VKM Nr. 435, datë 12.9.2002 “Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër”.
- 4.35** Përpara fillimit të aktivitetit, subjekti të ketë hartuar planin e monitorimit dhe të raportimit dhe ta dorëzojë pranë DRM-se dhe AKM-se.
- 4.36** Mbetjet e trajtuara, hiri të depozitohen në vendin e përcaktuar nga qeverisja vendore ose në të kundërt të depozitohen në venddepozitim më të afërt në përputhje me legjisllacionin në fuqi;
- 4.37** Para fillimit të veprimtarisë të trajtimit të gjithë punëtorët e subjektit si dhe të njihen me termat dhe kushtet e sipercituara në Deklaratë.
- 4.38** Subjekti duhet të respektojë gjithashtu edhe kushtet e vendosura të raportin e VNM-së që është paraqitur në aplikim si dhe të ketë parasysh të gjitha detyrimet që rrjedhin nga Ligji Nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”.
- 4.39** Në përfundim të punimeve dhe instalimit të impinatit, të sillen pranë AKM një raport mbi gjendjen e mjedisit të shoqëruar me foto dhe mbi punimet rehabilituese gjatë gjithë gjurmës së projektit.

**Duke qënë se gjatë fazës së funksionimit, ky aktivitet do të ketë efekte në mjedis, në bazë të Ligjit Nr. 60/2014 datë 19.6.2014, “Për një ndryshim në ligjin nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar, Shtojca I, duhet t’i nënshtrohet procedurave per paisje me Leje Mjedisore.**

## **5. Monitorimi dhe Raportimi.**

Në bazë të Ligjit Nr. 128/2020 Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, të ndryshuar, Neni 25/1 “Monitorimi dhe vlefshmëria”, zhvilluesi ka detyrimet si më poshtë:

### **- Zhurma dhe Vibracionet**

- Të zbatohen nivelet kufi të zhurmës, referuar Udhëzimit Nr. 8, date 27.11.2007 “Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara” dhe Ligjit Nr.9774 date 12.07.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”
- Të merren masa për mbrojtjen e punonjësve nga zhurmat.
- Të merren masat për kufizimin e orareve të punës në kantier.
- Operatori duhet të parandalojë gjenerimin e zhurmës impulsive në zonat e ndjeshme ndaj zhurmës, gjatë operimit të instalimeve.
- Vibrimet në vende të ndjeshme nuk duhet të kalojnë 10 mm/s (PPV) në çdo kohë.
- Të bëhet monitorimi i zhurmave për mjediset: automjete/kamiona në hyrje të kantierit, kantier ndërtimi dhe mjedisi urban më i afert me kantierin çdo 6 muaj.

*Tabela e niveleve kufi:*

<b>Mjedisi</b>	<b>Vlera kufi e zhurmës dB(A) Leq, T Ditë</b>	<b>Vlera kufi e zhurmës dB(A) Leq, T Mbrëmje</b>	<b>Raportimi në AKM</b>	<b>Periodiciteti</b>
Automjete/kamiona ne hyrje te kantierit	55	45	08.12.2024	Çdo 6 muaj
Kantier ndertimi	55	45	08.12.2024	Çdo 6 muaj
Mjedisi urban me i afert me kantierin	55	45	08.12.2024	Çdo 6 muaj

### **- Shkarkimet në Ajër**

- Të zbatohen nivelet kufi të shkarkimeve në ajër, referuar Ligjit Nr. 162/2014 “Për Mbrojtjen e Cilësisë së Ajrit në Mjedis” dhe VKM Nr. 248, datë: 24.03.2003 “Për Miratimin e Normave të Përkohshme të Shkarkimeve në Ajër dhe Zbatimin e tyre”.
- Shkarkimet në ajër të jene brenda normave të lejuara, duke marre masa për reduktimin e tyre.
- Kantieri në të cilin emetohen lëndë grimcore në ajër, duhet të pajiset sipas mundësive teknike dhe mbi bazën e natyrës së procesit, me rrjeta uji / sisteme spërkatje / sisteme heqje pluhurash.
- Të bëhet monitorimi i nivelit të pluhurave në ajër, për mjediset: kantier ndërtimi dhe mjedisi urban më i afert me kantierin çdo 6 muaj

*Tabela e niveleve kufi*

<b>Ndotësi</b>	<b>Përqëndrimi</b>	<b>Raportimi në AKM</b>	<b>Periodiciteti</b>
Lënda grimcore (PM <sub>2.5</sub> )	20-25 µg/m <sup>3</sup>	08.12.2024	Çdo 6 muaj
PM <sub>10</sub>	50 µg/m <sup>3</sup> , 40 µg/m <sup>3</sup>	08.12.2024	Çdo 6 muaj

- **Cilësia e ujrave**

*Parametrat që duhet të monitorohen*

<b>Ndotësi</b>	<b>Përqëndrimi</b>	<b>Raportimi në AKM</b>	<b>Periodiciteti</b>
Lëndët në pezulli	50 mg/l	08.12.2024	Çdo 6 muaj

- **Subjekti duhet të sjellë pranë AKM-së si më poshtë:**

- Informacion në momentin e fillimit të punimeve
- Raportimin periodik për parametrat që do të monitorohen sipas datës së raportimit/ çdo 6 muaj.
- Informacion në përfundim të punimeve, lidhur me punimet rehabilituese të territorit përreth, shoqëruar edhe me foto.

- **Afati i Vlefshmërisë**

- Vendimi për VNM-në paraprake për projektin e propozuar është e vlefshme për aq kohë sa është i vlefshëm edhe dokumenti i miratimit të zhvillimit për projektin.
- Nëse projekti, që i është nënshtruar procesit të VNM-së, nuk fillon zbatimin në terren brenda 2 vjetëve nga data e miratimit të deklaratës mjedisore apo të vendimit për VNM-në paraprake, atëherë këto dokumente konsiderohen të pavlefshme dhe procesi i VNM-së fillon nga e para.

*Në bazë të udhëzimit të MM dhe MF nr. 7938, datë 17.7.2014 “Për përcaktimin e tarifave dhe vlerave përkatëse për shërbimet që kryen Ministria e Mjedisit për procesin e VNM-së”, ky subjekt ka kryer pagesën 50.000 lekë.*

**DREJTORI I PËRGJITHSHËM**

**ARTA DOLLANI**

**MINISTRI**

**MIRELA KUMBARO FURX**

*Konceptoi:*

*Konfirmoi:*

*Pranoi:*



**Aneksi 1. Harta Topografike me koordinatat.**



**KOORDINATAT KU USHTROHET VEPRIMTARIA E KELVIS  
2013 PER INCENERIM MBETJESH-KRRGJSH**

X	Y
478806.69	4586150.07
478816.07	4586152.87
478817.61	4586148.95
478807.81	4586146.43

**KOORDINATAT KU USHTROHET VEPRIMTARIA E KELVIS  
2013 PER INCENERIM MBETJESH-GAUSS KRUGER**

X	Y
4395324.79	4587008.73
4395334.20	4587011.42
4395335.70	4587007.48
4395325.87	4587005.07